

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7040  
E hënë, 6 nëntor 2023  
Çmimi 0.50

## Kurti në mbledhjen e LV-së: S' do të mund të na ndalin as në jug e as në veri

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

TË DIELËN JANË BËRË TRI VJET PREJ QË HASHIM THAÇI, KADRI VESELI, JAKUP KRASNIQI DHE REXHEP SELIMI U ARRESTUAN NGA GJYKATA SPECIALE

# TRI VJET PADREJTËSI



Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 5 nëntor 2020 janë arrestuar e janë nisur drejt Hagës. Atje ata kanë nisur një betejë me drejtësinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës, me pretendimet për krime lufte, në gjykatën e cila u krijua për t'i

hetuar gjetjet e raportit të Dick Martyt. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës, me të cilat i ngarkon Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Procesi gjyqësor ka nisur në muajin prill të këtij viti. Në këtë proces janë rreth 300 dëshmitarë. Aktualisht dëshminë e kanë përfunduar 32 dëshmitarë. Pjesa më e madhe e tyre ka dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun

## AKTUALE



**NË 7-VJETORIN E VDEKJES, LV-ja PËRKUJTON AKTIVISTIN ASTRIT DEHARI** F. 2

**'GJYKIMI HISTORIK' NGA I CILI GREGORY KEHOE PRET TA NXJERRË HASHIM THAÇIN TË PAFAJSHËM SHPEJT** F. 5

**BRAKTISJA E SEANCEVE: VETËM 22 LIGJE TË MIRATUARA NË NJË SESION** F. 3

## EKONOMI



**INAUGUROHET RIHAPJA E TUNELEVE T6 DHE T7, PJESË E LINJËS HEKURUDHORE HANI I ELEZIT - FUSHË-KOSOVË** F. 7

**GËRXHALIU: TË NDALET SHKATËRRIMI I NËDËRMARRJEVE PUBLIKE PËRMES PRIVATIZIMIT APO PARTNERITETIT PUBLIKO-PRIVAT** F. 7

## SPORT



**PRISHTINA NDAHET BARAS ME LLAPIN, DRITA MPOSHTET NGA DUKAGJINI** F. 10

**QYTETARËT E KOSOVËS, PËRDORUES TË MËDHENJ TË INTERNETIT, PËR ÇFARË E SHFRYTËZOJNË?** F. 3



**QYTETARËT PËR, EKSPERTËT KUNDËR IMPORTIT TË VETURAVE MË TË VJETRA SE 10 VJET NË KOSOVË** F. 6



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky e fton Trumpin në Ukrainë

KIEV, 5 NËNTOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u ka bërë thirrje Shteteve të Bashkuara të ofrojnë më shumë ndihmë për luftim të Rusisë, dhe e ka ftuar ish-presidentin amerikan, Donald Trump, të shkojë në Ukrainë për ta parë shkallën e konfliktit me sytë e tij. Zelensky ka thënë se ushtarët amerikanë mund të përfshihen potencialisht në një konflikt më të madh evropian me Rusinë, nëse Uashingtoni nuk e rrit ndihmën. "Nëse Rusia na vret të gjithë neve, do t'i sulmojë vendet e NATO-s dhe ju do t'i dërgoni djemtë dhe vajzat tuaja [për të luftuar]", është cituar të ketë thënë Zelensky në një intervistë për rrjetin NBC, që do të transmetohet të dielën.

Presidenti amerikan Joe Biden, demokrat, i ka bërë thirrje Kongresit amerikan që ta miratojë një paketë ndihme në vlerë të 106 miliardë dollarëve,



dhe një pjesë e këtyre mjeteve është planifikuar të ndahet për Ukrainën.

Dhoma e Përfaqësuesve, e udhëhequr nga republikanët, ka insistuar që do t'i çojë përpara paketat e veta të financimit.

Ky institucion e ka miratuar javën e kaluar një paketë ndihme në vlerë të 14.3 miliardë dollarëve për Izraelin, mirëpo nuk e ka rritur ndihmën për Ukrainën.

Përgjatë intervistës, Zelensky e ka ftuar ish-presidentin amerikan

Donald Trump, republikan, që ta vizitojë Ukrainën dhe ta shohë shkatërrimin që ka lënë mbrapa lufta e nisur nga Rusia në shkurt të vitit 2022.

Trump, i cili synon ta fitojë edhe një mandat presidencial më

2024, dhe është kandidat kyç për ta fituar nominimin e partisë së tij, ka qenë kritik i ashpër i ndihmës amerikane për Kievin, dhe ka thënë se do t'i japë fund luftës brenda 24 orëve, nëse zgjedhet. "Nëse mund të na vizitojë këtu, më duhen 24 minuta për t'ia sqaruar presidentit Trump që ai nuk mund ta menaxhojë këtë luftë. Ai nuk mund të sjellë paqe për shkak të Putinit", ka thënë Zelensky.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Abbas i kërkon ShBA-së të sigurojë armëpushim në Gazë

RAMALLAH, 5 NËNTOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, e ka realizuar një vizitë të papritur në Bregun e pushtuar Perëndimor të dielën, dhe është takuar me presidentin e Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas, në kuadër të udhëtimeve në atë rajon.

Blinken dhe Mahmoud Abbas janë takuar në qytetin e Bregut Perëndimor, Ramallah, në vizitën e dytë të diplomatit amerikan prej shpërthimit të luftës Izrael - Hamas.

Militantët e Hamasit kanë nisur sulme në jug të Izraelit më 7 tetor, duke i vrarë mbi 1 400 njerëz dhe duke i marrë mbi 240 pengje. Izraeli më pas i ka shpallur luftë Hamasit, i cili udhëheq Gazën.

Teksa Izraeli i vazhdon sulmet ajrore në Gazë, autoritetet palestineze kanë thënë se mbi 9 500 njerëz janë vrarë.

Blinkeni ka bërë thirrje, por pa sukses, që Izraeli të pajtohet për

pauza humanitare, që të mund të dërgohen ndihma në Gazë.

Përveç që synon të sigurohet se konflikti nuk do të përhapet më tej në rajon, Blinkeni dëshiron t'i nisë diskutimet se si do të qeveriset Gaza, pas shkatërrimit të Hamasit, të cilin e synon Izraeli. Dy liderët kanë diskutuar për gati një orë, por nuk janë deklaruar para medieve.

Abbas i ka thënë Blinkenit se duhet të arrihet armëpushim i menjëhershëm dhe që duhet të mundësohet dërgimi i ndihmës në Gazë, sipas zëdhënësit të tij, Nabil Abu Rudeineh.

Blinkeni ka thënë se Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara për të dërguar ndihmë në Gazë dhe për riparim të shërbimeve thelbësore, ka thënë zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Matthew Miller.

Blinken besohet se ka sugjeruar "rivitalizim të Autoriteteit Palesinez" ashtu që të mund ta



udhëheqë Rripin e Gazës, mirëpo e ka pranuar që edhe shtete e agjenci të tjera do të luajnë rol në sigurinë dhe qeverisjen e përkohshme.

Autoriteti Palesinez, të cilin e udhëheq Abbas, ushtron ndikim

të pjesshëm në Bregun e pushtuar Perëndimor, dhe është përballur me përkrahje të zbehur, për shkak të pakënaqësive të palestinezëve për marrëveshjet e arritura me Izraelin.

Ende nuk dihet se kush do të jetë

pasardhës i Abbasit, i cili njihet si kundërshtar i ashpër i Hamasit.

Dhuna në Bregun e pushtuar Perëndimor është rritur prej nisjes së luftës, pasi janë regjistruar mbi 170 sulme në atë pjesë.

## CHP-ja opozitare turke zgjedh liderin e ri pas humbjeve në zgjedhjet e majit



Ankara, 5 nëntor - Lideri opozitar turk Kemal Kılıçdaroglu është detyruar të japë dorëheqje të dielën, pasi Partia Popullore Republikane (CHP) e ka zgjedhur Ozgur Ozelin kryetar të ri, pas humbjes në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të majit.

Delegatët e kanë përkrahur 49-

vjeçarin Ozel, në garë me Kılıçdaroglu, 74-vjeçar, i cili e ka udhëhequr partinë në 13 vjetët e fundit.

Pavarësisht se e pati mbledhur një aleancë të madhe për zgjedhjet e 14 majit, Kılıçdaroglu ka dështuar të triumfojë.

Ozel, aleat politik i kryetarit të Stambollit, Ekrem İmamoglu, ka

bërë thirrje për reforma në parti, më të vjetrën në Turqi.

CHP synon t'i ruajë pozitën e rëndësishme komunale që ka në Stamboll dhe Ankara në zgjedhjet e vitit të ardhshëm për komuna. Ozel, me profesion farmacist, ka shërbyer paraprakisht si udhëheqës parlamentar i CHP-së.

# Kurti në mbledhjen e LV-së: S'do të mund të na ndalin as në jug e as në veri

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se Lëvizja Vetëvendosje dhe qeverisja e tyre janë të pandalshme dhe pavarësisht se kush e ku i pengon, ata nuk do të mund t'i ndalë askush as në jug dhe as në veri. "Lëvizja jonë, po ashtu edhe qeverisja jonë, janë të pandalshme pavarësisht se kush e si, e kur e ku na pengon. U thoni të gjithë aktivistëve e qytetarëve që nuk do të mund të na ndalin as në jug as në veri. Sot u bënë 6 javë që na e vranë rreshterin e policisë, heroin e Kosovës, Afrim Bunjaku, por në vitin 2024 do të kemi 600 ushtarë më shumë dhe 500



policë më shumë për ligj e kushtetutshmëri, për mbrojtje e siguri për Kosovën tonë", ka

thënë ai në takimin e Lëvizjes Vetëvendosje. Kurti theksoi se ndryshimi që

"ne dëshirojmë të sjellim në Kosovë për ta kapur hapin e zhvillimit të vendeve evropiane është ende në fillimet e tij andaj duhet të angazhohemi si strukturat që të zgjerohet komunikimi ynë me popullin që të kuptohen drejt nevojat dhe mundësitë që kemi, e që të ecim së bashku drejt zhvillimit progresist".

Duke kujtuar rëndësinë e angazhimit në nivel të pikave, ai përmendi tri detyra që aktivistët duhet t'i bëjnë në punën e tyre. "Së pari, nga aktivistët e angazhuar në pikat e Vetëvendosjes duhet të fillojë një punë me qytetarët, që ata të ndihmohen të kuptojnë më mirë se çka janë detyrat e qeverisjes lokale dhe asaj qendrore, e çka mund të

kërkohej prej këtyre niveleve të qeverisjes. Së dyti, nga ju, që jeni përfaqësuesit tanë të përditshëm në lagjet e fshatrat e Kosovës, presim angazhimin që së bashku t'i identifikojmë liderët lokalë, drejtuesit e rinj, që do të angazhohen në zgjedhjet e ardhshme lokale si kandidatë për asamble komunale, apo edhe për kryetarë komunash. Së treti, të dashur bashkëqytetarë, nuk duhet të harrojmë diçka: angazhimi politik do të thotë aktivitet i dendur. Pra do të thotë organizim takimesh dhe pjesëmarrje në takime. Do të thotë lexim e analizë. Pikat tona e qendrat tona duhet të mblidhen e të diskutojnë, sepse pa diskutim nuk ka politizim", ka deklaruar Kurti.

## Në shtatëvjetorin e vdekjes, LV-ja përkujton aktivistin Astrit Dehari

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Të dielën, në shtatëvjetorin e vrasjes së Astrit Deharit, kryeministri Albin Kurti, bashkë me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, nënkryetaren e Kuvendit, Saranda Bogujevci, me anëtarë të kryesisë së Lëvizjes, ministria, deputetë, aktivistë, fillimisht vizituan familjen Dehari e më pas, bashkë me ta dhe shoqëri të gjerë, bënë homazhe te varri i Astrit Deharit.

"Kujtojmë dhe nuk harrojmë që 7 vjet më parë Astriti u vra në burgun e Prizrenit ku po mbahej në paraburgim pa aktakuzë, pa gjykim, pa dënim, dhe pa u marrë në pyetje për 68 ditë", është thënë në njoftimin e LV-së.

Kryeministri Kurti në prononcimin e tij për medie tha se 7 vjet pas vrasjes së Astritit, Kosova ka shënuar përparim, por ende nuk



mund të jetë shtet i së drejtës pa u zbardhur rastet si ky, pa u zbardhur rasti i Astrit Deharit dhe pa u dënuar përgjegjësit.

Ai u bëri thirrje organeve të drejtësisë t'i trajtojnë me urgjencë padrejtësitë dhe krimet e të mos i zvarrisin ato. "Shtatë vjet prej se atë

të shtune pasdite morëm lajmin e kobshëm, se shokun tonë, aktivistin e Lëvizjes, studentin shembullor të mjekësisë, Astrit

Deharin, e kanë mbytur në burgun e Prizrenit. Shtatë vjet më vonë Kosova ka shënuar progres sa i përket demokracisë e lirisë, mirëpo Kosova nuk mund të jetë shtet i së drejtës në kuptimin e plotë të fjalës pa u zbardhur plotësisht ky rast dhe pa u dënuar përgjegjësit, dhe jo vetëm ky rast, por edhe rastet e tjera të pasqaruara në Kosovë. Me mbytjen e Astritit ne e kemi humbur një aktivist, patriot të pazëvendësueshëm, por ideali i Lëvizjes sonë nuk ka zëvendësim e ai është ideali i Astritit për liri e drejtësi, për barazi e demokraci, për zhvillim e për bashkim. Sistemi i drejtësisë në Kosovë, edhe prokuroria edhe gjyqësori, duhet që padrejtësitë dhe krimet t'i trajtojnë me urgjencë e kurrësi t'i zvarrisin nga muaji në muaj, nga viti në vit", ka thënë Kurti.

## Braktisja e seancave: Vetëm 22 ligje të miratuara në një sesion

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Herë opozita lëshon sallën, herë pushteti. Ka kohë që deputetët e Kuvendit të Kosovës nuk gjejnë gjuhë të përbashkët.

Të enjten e kësaj jave ishin partitë opozitare ato që e braktisën seancën, pasi partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, doli kundër propozimit të tyre për të diskutuar për grevën e minatorëve të "Trepçës" dhe për kërkesat e Policisë së Kosovës.

Të enjten e javës së kaluar Vetëvendosja la seancën, pasi kërkesa e saj për të diskutuar pikat e mbetura të seancave të kaluara e pastaj propozimin e opozitës për koeficientin e pagave nuk kaloi.

Kjo legjislaturë prej 120 deputetësh është konstituuar

më 22 mars të vitit 2021.

Zyra për Informim e Kuvendit të Kosovës nuk iu përgjigj pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" rreth ligjeve të miratuara dhe atyre në procedurë, por organizatat që monitorojnë punën e Kuvendit thonë se një përqindje e madhe e tyre nuk ka kaluar. "Mosbashkëpunimi i partive parlamentare dhe ikja nga përgjegjësia e deputetëve, duke i braktisur seancat, mund të përfundojë me dështim të punës së Kuvendit", thotë Arbër Thaçi, hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (IDK) për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas tij, në sesionin pranveror të Kuvendit këtë vit, që ka nisur në janar dhe ka përfunduar në gusht, kanë qenë të planifikuara 130

projektligje për shqyrtim, ndërsa janë miratuar vetëm 22 prej tyre, ose 17.13 për qind. Sipas IDK-së, disa prej tyre, nga muaji prill, "janë bartur në 30 seanca të Kuvendit", por nuk janë miratuar - herë në mungesë kuorumi, herë në mungesë të votave të mjaftueshme.

Me ligjin në Kosovë marrëveshjet ndërkombëtare mund të ratifikohen vetëm me votat e 2/3 së deputetëve.

Duke e fajësuar pushtetin për një sërë çështjesh, si keqmenaxhim të buxhetit dhe mosbashkëpunim me aleatët ndërkombëtarë, shumë deputetë të opozitës u zotuan muajin e kaluar se nuk do të votojnë asnjë marrëveshje ndërkombëtare derisa vendi nuk shkon në zgjedhje të reja.





TË DIELËN JANË BËRË TRI VJET PREJ QË HASHIM THAÇI, KADRI VESELI, JAKUP KRASNIQI DHE REXHEP SELIMI U ARRESTUAN NGA GJYKATA SPECIALE

# TRI VJET PADREJTËSI

Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 5 nëntor 2020 janë arrestuar e janë nisur drejt Hagës. Atje ata kanë nisur një betejë me drejtësinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës, me pretendimet për krime lufte, në gjykatën e cila u krijua për t'i hetuar gjetjet e raportit të Dick Martyt. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës, me të cilat i ngarkon Zyra e Prokurorit të Specializuar. Procesi gjyqësor ka nisur në muajin prill të këtij viti. Në këtë proces janë rreth 300 dëshmitarë. Aktualisht dëshminë e kanë përfunduar 32 dëshmitarë. Pjesa më e madhe e tyre ka dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun

EPOKA E RE

## Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më 5 nëntor 2020 janë arrestuar dhe janë nisur drejt Hagës. Atje ata kanë nisur një betejë me drejtësinë e Dhomave të Specializuara të Kosovës, me pretendimet për krime lufte, në gjykatën që u krijua për t'i hetuar gjetjet e raportit të Dick Martyt. Për tri vjet ish-udhëheqësve të UÇK-së nuk iu dha asnjë mundësi për mbrojtje në liri. As në ndonjë vend të tretë, edhe pse ato patën shprehur garanci. Ata ende mbesin në paraburgim në Hagë.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi para trupit gjykues janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha pikat e

aktakuzës, me të cilat i ngarkon Zyra e Prokurorit të Specializuar e që lidhen me krime lufte.

Procesi gjyqësor ka nisur në muajin prill të këtij viti. Në këtë proces janë rreth 300 dëshmitarë. Aktualisht dëshminë e kanë përfunduar 32 dëshmitarë. Pjesa më e madhe e tyre ka dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun.

Kohën e fundit Prokuroria e Speciales ka nisur një aksion të bastisjeve nëpër shtëpitë e ish-këshilltarëve të presidentit Thaçi, me pretendimet për pengim të drejtësisë.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut ka reaguar pas bastisjeve nga Gjykata Speciale, duke thënë se po bëhet dhunë psikologjike.

Në reagimin e KMDLNj-së thuhet se në këtë mënyrë po

shënjestërohen të gjithë ata që, siç thuhet, në një mënyrë apo tjetër po e kundërshtojnë këtë

gjykatë. "Realisht, mund të flasim për një dhunë psikologjike dhe pasiguri të shkaktuar për shkak të bastisjeve të paparalajmëruara dhe mbajtja nën presion të personave të bastisur për një kohë të gjatë deri në një vendim të gjykatës. Në këtë mënyrë po shënjestërohen të gjithë ata që në një mënyrë apo tjetër po e kundërshtojnë këtë gjykatë sikur edhe ata që kanë qenë në marrëdhënie të punës tek udhëheqësit e UÇK-së dhe të institucioneve shtetërore të

Kosovës në çfarëdo cilësie", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Të dielën në vendin tonë ka pasur reagime për padrejtësinë që po u bëhen ish-krerëve të UÇK-së.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, së bashku me bashkëpunëtorë, ka vizituar familjen e Hashim Thaçit dhe të Kadri Veselit. Ai ka thënë se heronjtë janë më shumë se individë, paçka se bartin emra të përveçëm. "Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep





Selimi dhe shokët e tyre simbolizojnë forcën, kurajën dhe frymëzimin i cili ka përbashkuar një popull. Pavarësisht nga muret dhe kufizimet, shembulli dhe emri i tyre në mënyrë të pashmangshme i tejkalon ato dhe shkëlqen mbi Kosovë, duke ndriçuar rrugën për brezat që do të vijnë. Sot është obligimi ynë ta vazhdojmë ëndrën dhe punën e tyre për shtetndërtim e fuqizim të kombit tonë. Këtë ua thashë edhe familjarëve gjatë vizitave të sotme te ta. Tre vjet kaluan, mund të kalojë edhe ndonjë tjetër, mirëpo një gjë është e sigurt: Dielli do të lindë përsëri!", ka thënë Krasniqi.

Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Ganimete Musliu, e cila nuk ka votuar për themelimin e Gjykatës Speciale, në "Facebook" ka shkruar: "Tri vjet padrejtësi!". Ajo ka thënë se Gjykata Speciale u themelua për t'i zbardhur pretendimet e Dick Martyt e jo për qerim hesapesh personale dhe politike. "Një thënie e urtë thotë: 'Mos i vrisni luanët e vendit tuaj, sepse do t'ju shqyejnë qentë e armikut tuaj'. Kosova sot në mungesën e këtyre luanëve po sulmohet çdo ditë nga qentë e armikut", ka shkruar ajo në "Facebook".

Edhe ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka reaguar në rrjetet sociale, duke theksuar se emrat e këtyre çlirimtarëve do ta lartësojnë edhe më shumë luftën e drejtë të UÇK-së dhe të popullit të Kosovës, duke u kthyer fitimtarë nga kjo betejë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në trevjetorin e ngritjes së aktakuzës ndaj ish-kreerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë, ka thënë se "gabimet e pushteteve të kaluara po peshojnë rëndë edhe sot". "Mbetemi të patundur në bindjen se UÇK-ja e drejtë, është edhe e pastër, prandaj i kemi kundërshtuar gjykimet e padrejta atëherë kur vendosej për to. Por, ja që gabimet e pushteteve të shkuara ende peshojnë dhe ende dëmtojnë", ka thënë Kurti në mbledhjen e Lëvizjes Vetëvendosje të mbajtur të dielën.

Kurti e ka përmendur bashkëpartiakun e tij, Rexhep Selimin, të njohur në luftë si 10-shi i UÇK-së, i cili po mbahet në paraburgim në Hagë. "Rexhep Selimi tash e tre vjet po vuan në burgun e Hagës. Mezi presim të na kthehet", shtoi ai.

### 'Gjykimi historik' nga i cili Gregory Kehoe pret ta nxjerrë Hashim Thaçin të pafajshëm shpejt

Të vështirë e historik mbi të gjitha, Gregory Kehoe, avokati kryesor i presidentit Hashim Thaçi, e sheh procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj tij, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit në Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë. Megjithatë shpreh optimizëm se klientin e tij president do ta nxjerrë shpejt të lirë, para se t'i vijë radha vetë Kehoes e mbrojtësve të tjerë ta paraqesin mbrojtjen e provat e tyre në gjykatore. "Mendoj se do të përpiqem ta nxjerr presidentin sapo Prokuroria ta përfundojë paraqitjen e provave dhe shpresoj ta fitoj mocionin që të

mos kemi çfarë të përgjigjemi, deri tashti nuk shoh ndonjë fuqi në provat që ka Prokuroria e që lidhen me presidentin Thaçi. Por nëse na duhet të vazhdojmë me mbrojtjen, do ta paraqesim rastin, megjithatë e vështirë të flitet në këtë fazë. Po përmbahem sepse nëse ju jap një afat kohor, vërtet që nuk e di se çfarë do të sjellë prokuroria që të përgjigjem, por nëse do të jemi të detyruar të paraqesim provat tona, kemi një valë të dëshmitarëve ndërkombëtarë që do të flasin për presidentin Thaçi, do të dëshmojnë për faktin se presidenti Thaçi, veçanërisht pas luftës, është përpjekur të sjellë paqe dhe pajtim në Kosovë, personi që është përpjekur t'i bindë serbët të mos largohen, dikush që shtynte përpara idenë e një shoqërie multietnike, dikush që udhëtonte drejt vendeve të ndryshme në kohë të ndryshme e që përpiqej të

mënjante ndonjë përshkallëzim potencial dhe tërë këto veçse janë dokumentuar nëpër media përmes videove dhe shkrimeve, pra ai ka qenë personi që i ka bërë të gjitha këto vetëm pak ditë pas luftës. E sa kohë do të na marrë neve ta paraqesim gjithë këtë skenar, shpresoj të marr pak ndihmë nga mediet që mund të hulumtojnë pak për ne. Dhe jo vetëm mediet e Kosovës, por mediet nga mbarë bota, që i kanë përcjellë dhe mbuluar ngjarjet e luftës gjatë '98-s dhe '99-s'.

Në një intervistë me gazetarë të "Klan Kosovës", "Nacionale" e "RTK", nga Haga, Kehoe ka treguar se si kanë qenë 3 vjet në paraburgim për Hashim Thaçin teksa priste nisjen e vonuar të gjykimin. "Mendoj se ka qenë shumë e vështirë për presidentin. Ai po mbahet tash e tri vjet dhe ka qenë në masën e paraburgimit gjatë gjithë kësaj periudhe.

Vazhdimisht jemi përpjekur ta nxjerrim jashtë, por nuk kemi pasur sukses në atë drejtim. Nuk mendoj se ka ndonjë arsye që ai të vazhdojë të qëndrojë në paraburgim. Natyrisht ai duhet të jetë në mbajtje ndërkohë që ka gjykim, por ka mangësi sa i përket orarit të gjykatës. Për shembull, në raste festash ai sigurisht mund të lirohet. Pra në rrafshin personal për të ka qenë shumë e vështirë, por ai po mbahet, ka kurajë dhe më duhet ta them, siç po bëjnë edhe tre zotërinjtë e tjerë, ka qenë e vështirë sepse gjykimi është zhvilluar ngadalë e do të vazhdojë të jetë i ngadalshëm. Prokuroria ka goxha dëshmitarë dhe mendoj se do të marrë ca kohë. Por do t'juja them edhe këtë, do të vazhdojmë të përpiqemi ta lirojmë nga paraburgimi gjatë muajve në vijim dhe do t'ju njoftoj si do të shkojë", ka theksuar Kehoe.



## Bislimi: Mos inkurajoni agresorët duke gjykuar viktimat, na ktheni presidentin në atdhe

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Të dielën u bënë tri vjet nga arrestimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë, ndryshe siç njihet Gjykata Speciale.

Sali Bislimi, veprimtar, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, dhe drejtor i organizatës

joqeveritare “Zëri Perëndimor i Kosovës”, ka shkruar në “Facebook” se Kosova ishte në mbrojtje legjitime, si Ukraina sot. “Mos inkurajoni agresorët duke gjykuar viktimat. Demokracia Perëndimore nuk duhet të lejon të fiton padrejtësia. 600 vite të robëruar më lehtë pranuar këtë gjykatë të padrejtë se të

bëjmë një padrejtësi. Drejtësinë dhe lirinë e kemi ëndërruar me shekuj, e bëmë dashuri që e drejtuam pa kushte tek ju me të cilën sot po abuzoni. Jemi dhe mbetemi të revoltuar. Mos dhunoni lirinë e Kosovës. Ndalojeni spektaklin e padrejtësisë na ktheni Presidentin në atdhe”, ka shkruar Bislimi.



## Qytetarët e Kosovës, përdorues të mëdhenj të internetit, për çfarë e shfrytëzojnë?

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Plot ulëse përreth fakulteteve në kompleksin e Universitetit të Prishtinës janë të zëna nga studentët që rrinë në telefonat e tyre, herë pas here ngrënë kokën për të folur me njëri-tjetrin.

Para Fakultetit të Filozofisë e ulur qëndron edhe Viola Fazliu, e cila pret që pas pak të takohet me studenten e historisë, Aulona Fazliu, siç ishin marrë vesh përmes telefonit. Ato tregojnë se janë përdoruese të rregulla të internetit. “Më së shumti e përdorim për rrjetet sociale - Instagram, Tiktok etj. - për komunikim me shoqëri, por edhe për informim”, thotë Aulona për “Radion Evropa e Lirë”. Përdorues të rregullt, si Aulona dhe Viola, janë shumica e banorëve të Kosovës. Ndër vite përqindja e atyre që kanë qasje në internet është rritur në mënyrë konstante. Tani pothuajse 99 për qind e kosovarëve kanë qasje në internet, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të nxjerra në fund të tetorit. Prej vitit 2017 e deri këtë vit përqindja e familjeve që kanë qasje në internet në Kosovë është rritur vazhdimisht. Tani vetëm 1.4 për qind e familjeve janë pa qasje në internet.

Të dhënat e Zyrës së Bashkimit Evropian për Statistika (Eurostat) tregojnë se qasja në internet në Kosovë është më e lartë sesa në shumë vende të tjera të Evropës. Madje përqindja e familjeve në Kosovë që kanë qasje në internet është më e lartë sesa mesatarja në Bashkimin Evropian.

Pjesa më e madhe e përdoruesve të internetit në Kosovë janë online disa herë gjatë ditës dhe u përkasin grupmoshave prej 16 deri në 34 vjeç. Ndërsa, ndër vite, ata mbi 65 vjeç kanë përdorur internetin më së paku në vend.

Numri i banorëve në Kosovë që e përdorin internetin disa herë në ditë u rrit edhe më shumë më 2023 në krahasim me vitin e kaluar.



Ndërsa numri i atyre që e përdorin internetin më pak se një herë në javë u zvogëlua në vetëm 0.1 për qind të banorëve.

Edhe pse banorët e Kosovës janë përdorues të mëdhenj të internetit, shërbimet që ata i kryejnë online janë të limituara. Aldo Baxhaku, zyrtar për komunikim publik në Shoqatën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK), thotë se janë disa faktorë që ndikojnë në nivelin e shkathtësisë digjitale të një personi. “Shumica e qytetarëve në Kosovë i shfrytëzojnë telefonat për qasje në internet dhe shërbimet që janë më të sofistikuara kryhen përmes laptopëve apo kompjuterëve. Ndërsa informimi dhe argëtimi bëhen përmes telefonave mobilë”, thotë Baxhaku për “Radion Evropa e Lirë”.

Të dhënat e ASK-së tregojnë se gati 95 për qind e përdoruesve të

internetit në Kosovë qasen në të përmes kompjuterëve.

Baxhaku shton se të rinjtë e shkolluar dhe që kanë mundësi të ndjekin kurse shtesë kanë shkathtësi më të mëdha digjitale pasi që, sipas tij, standardet për ta quajtur një person të shkathtë në aspektin digjital tani janë ngritur. “Ka ndryshuar koncepti i shkathtësisë digjitale. Më herët shkathtësi digjitale konsiderohej ta hapje kompjuterin, ta hapje një llogari. Tani shkathtësi digjitale quhet kur di të kodosh, të përpunosh të dhëna etj.”, thotë ai. Të dhënat tregojnë se në shumicën e rasteve kosovarët i përdorin rrjetet e tyre sociale Facebook, Instagram e X për të komunikuar me të afërmit e tyre dhe për informim.

Edhe pse Kosova gjatë viteve të fundit ka digjitalizuar disa shërbime institucionale - si tërheqjen e dokumenteve të

gjendjes civile - përmes platformës E-Kosova, shumica e banorëve të vendit thonë se nuk kanë përdorur shërbime të tilla gjatë vitit të fundit. Mbi 80 për qind e përdoruesve të internetit, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, as nuk e kanë përdorur internetin për të siguruar materiale mësimore apo për kurse online.

Edhe pse shumica e banorëve në Kosovë kanë qasje në internet, shumë pak prej tyre e përdorin për qasje në materiale mësimore apo për marrje të shërbimeve qeveritare.

Por, Diellza Osmani, dizajnere grafike, e gjen veten në mesin e asaj pakice që përdor internetin për gjëra që ia lehtësojnë jetën si për punë apo shërbime institucionale e jo për argëtim. “Për komunikim preferoj të takohem me njerëzit drejtpërdrejt. Madje shpeshherë e harroj telefonin në shtëpi”, thotë

ajo duke qeshur.

Ndërkohë numri i personave që kanë bërë blerje online është rritur me kalimin e viteve. Më 2018 vetëm rreth 17 për qind e banorëve të Kosovës kishin bërë blerje online brenda tre muajve të fundit para se të bëhej anketa. Në vitin 2022 kjo shifër u rrit në gati 43 për qind.

Të dhënat e këtij viti tregojnë se numri i banorëve të Kosovës që kanë bërë blerje online në tre muajt e fundit është pothuajse dyfish më i madh se i atyre që s'kanë bërë blerje online asnjëherë. Megjithatë, banorët në Kosovë bëjnë ende shumë më pak blerje online sesa në plot vende të tjera të Evropës.

Banorët në pjesën veriore të Evropës përdorin internetin për blerje online dukshëm më shumë se ata në pjesën jugore të këtij kontinenti. Nga vendet e rajonit, Kosova radhitet e dyta, pas Kroacisë.

## Në hapësirat e Qendrës Rinore në Deçan, Ramosaj takon rininë

Deçan, 5 nëntor - Në hapësirat e Qendrës Rinore në Deçan, e cila është përruar këto ditë, kryetari i kësaj komune, Bashkim Ramosaj, ka mbajtur një takim me rininë. Ai ka

shkruar në “Facebook”: “Sot, me rininë e Deçanit, në një takim miqësor në hapësirat e Qendrës Rinore, në vendin ku ata janë në shtëpinë e tyre, ku mund t'i realizojnë të gjitha aktivitetet, qoftë

inovative, trajnuese, edukuese, kreative, sportive, kinema, amfiteatër, takime pune, e çdo ide që kanë ata. Bashkë me rininë më të mirë në vend!”, ka shkruar Ramosaj.



## Inaugurohet rihapja e tuneleve T6 dhe T7, pjesë e linjës hekurudhore Hani i Elezit - Fushë-Kosovë

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në fundjavë është inauguruar rihapja e tuneleve T6 me gjatësi prej 262 metrash dhe T7 me gjatësi prej 122 metrash si pjesë e aksit të linjës hekurudhore Hani i Elezit - Fushë-Kosovë. "Tashmë po punohet intensivisht për plotësimin e të gjithë elementëve të tjerë të nevojshëm për funksionalizimin dhe rehabilitimin e Linjës së 10 Hekurudhore, që përfshin edhe linjat e tjera si Fushë-

Kosovë - Mitrovicë dhe Mitrovicë - Leshak", ka thënë Liburn Aliu, ministër i Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës.

Ai ka falënderuar Zyrën e Bashkimit Evropian dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Bankën Evropiane për Investime (EIB), si dhe Fondin për Investime për Ballkanin Perëndimor (WBIF) për bashkëpunimin e vazhdueshëm për

realizimin e këtij projekti. Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se me Linjën 10 dhe me hekurudhën Prishtinë - Durrës po e bëjnë Kosovën pjesë të Rrjetit të Transportit Trans-Evropian. Ai ka theksuar se lidhjet infrastrukturore po i forcojnë, zgjerojnë dhe modernizojnë. "Me forcim rriten shkëmbimet. Me zgjerim rritet ndërlihdja, ndërkaq me modernizim rritet shpejtësia", është shprehur Kurti.



## Qytetarët për e ekspertët kundër importit të veturave më të vjetra se 10 vjet në Kosovë

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Në rrugët e Kosovës vazhdon të ketë automjete të viteve '80, të cilat, përveç që ndotin ambientin, janë edhe të pasigurta në komunikacion. Megjithatë, ekspertë dhe drejtues të institucioneve nuk e shohin të rrugës që qytetarëve t'u mundësohen regjistrimi i veturave të kapshme për xhepin e tyre e të cilat do të ndikonin për një ambient më të mirë dhe siguri më të madhe në rrugë.

Në vendin tonë mbetet në fuqi ligji me të cilin një veturë mund të regjistrohet dhe të pajisjet me targat RKS, vetëm nëse është nga viti 2013-2023, konkretisht 10 vjet më e vjetër nga viti ekzistues.

Për një numër të madh të qytetarëve regjistrimi i veturave të vitit 2013 është i pamundur për shkak se deri te targat, më e lira do t'i kushtonte rreth 3 500 euro, pa llogaritur blerjen e veturës në vendet evropiane dhe koston e importit deri në Kosovë.

Qytetarët janë për ndryshimin e ligjit aktual, i cili nuk lejon regjistrimin e veturave nga viti 2000-2010. Ata thonë se, përveç ruajtjes së ambientit, veturat e viteve 2000 janë më të sigurta sesa ato të viteve të mëhershme, të cilat qarkullojnë ende në rrugët e Kosovës.

Kurse ekspertë të mjedisit dhe komunikacionit e konsiderojnë të dëmshëm dhe me efekte negative heqjen e kufizimit për importin e veturave më të vjetra se 10 vjet.

Ka disa vjet prej kur deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Mërgim Lushtaku, ka iniciuar plotësim-ndryshimin e ligjit për importin e veturave, ku kërkohet heqja e kufizimit të vjetërsisë, por që ende nuk është marrë një



vendim i tillë.

Lushtaku në një prononcim për "KosovaPress" thotë se ky ligj në Kosovë është krijuar me një standard të dyfishtë, derisa potencon se një gjë e tillë i duket e padrejtë, por që nuk po gjen pajtueshmëri të deputetëve shumicë që të marrin pjesë në votim.

Ndërkaq sa i përket akcizës doganore, Lushtaku thotë se nevojiten ndryshime, derisa thekson se për veturat e reja duhet të ketë një normë më të vogël të akcizës.

Në maj të vitit të kaluar Qeveria e Kosovës pati diskutuar për lejimin e importit të veturave më të vjetra

se dhjetë vjet. Zyrtarë të saj patën thënë se "në kuadër të analizave për shikimin e politikave tatimore, janë duke e trajtuar një opsion të tillë". Por, pavarësisht kësaj, ende nuk ka ndonjë ndryshim të vendimit.

Ministria e Infrastrukturës në një përgjigje përmes emailit thotë se janë duke hulumtuar mënyrën e rregullimit të importit të automjeteve në funksion të mbrojtës në kuadër të një projekti të financuar nga Qeveria e Japonisë.

Ndryshe nga deputeti Lushtaku, lidhur me propozimin që në Kosovë të mund të importohen veturat më të vjetra se 10 vjet,

mendon eksperti i komunikacionit, Muhamed Krasniqi. Ai thotë se me miratimin e këtij vendimi do të krijohet një deponi e automjeteve në Kosovë. Ai shton se qeveria duhet ta favorizojë importimin e automjeteve të reja në vend të atyre të vjetra.

Ndërkaq eksperti i mjedisit, Zeqir Veselaj, për "KosovaPress" thotë se qytetarët e Kosovës duke qenë në gjendje jo të mirë ekonomike, favorizohen nga ky vendim por që, sipas tij, në aspektin mjedisor do të shkaktojë ngarkesë në cilësinë e ajrit. Ai shton se automjetet janë ndotësit e dytë më të mëdhenj në Kosovë, menjëherë pas

termocentraleve, në mungesë të industrisë.

Se qytetarëve iu konvenon një vendim i tillë, e pohojnë vetë ata. Qytetari Gjergj Lumezi shprehet se po të ndryshohej 10-vjeçari në 15, sa i përket kufizimit, do të ishte më mirë.

Njëjtë mendon edhe Mehdi Gashi, teksa thotë se e ka një veturë të viteve '87 që nuk e ndërron me asnjë automjet tjetër. Ai shton se 'ne nuk kemi standarde për të ndryshuar vitet e prodhimit'.

Në nenin 44 të Ligjit për Automjete që është miratuar qysh në vitin 2017, thuhet se "mjetet rrugore që importohen në Kosovë nuk mund të jenë më të vjetra se 10 vjet".

## Gërxhaliu: Të ndalet shkatërrimi i ndërmarrjeve publike përmes privatizimit apo partneritetit publiko-privat

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Safet Gërxhaliu, ish-kryetar i Odës Ekonomike (OEK), ka bërë thirrje që të ndalet shkatërrimi i ndërmarrjeve publike përmes privatizimit apo partneritetit publiko-privat. "Duke pasur parasysh privatizimin e egër që e

ka përcjellë Kosovën e pasluftës, ku me qindra ndërmarrje publike dhe shoqërore janë shkatërruar dhe në vend se të jenë në funksion të zhvillimit, punësimit dhe përmirësimit të bilancit të pagesave, ato janë poligone ndërtimi apo destinacione të tjera

me pak efekte ekonomike në interes të shtetit dhe shoqërisë. Mirëpo, duke pasur parasysh politizimin, keqmenaxhimin, joprofesionalizimin dhe shkatërrimin e ndërmarrjeve publike aktuale siç janë: Trepça, Posta, Telekom, Infrakosi, KEK-

u, Trainkosi etj., vijmë në konstatim se shpëtimi i këtyre ndërmarrjeve publike është vetëm përmes partneritetit publiko-privat ose privatizimit në norma dhe standarde ndërkombëtare", ka thënë Gërxhaliu.



# Aleanca shiite në shënjestër forcat amerikane?

Fjalimi i gjatë i shefit të Hezbollahut e zhvendosi bariqendrën e aleancës shiite: Nga Gaza, për tek sulmet kundër Shteteve të Bashkuara. Një kërcënim, që e kanë treguar se nuk është vetëm teorik...

Nga 18 tetori, kanë ndodhur 44 sulme kundër bazave amerikane në Siri dhe Irak. Sulmi i fundit ndodhi vetëm pak orë pas fjalimit të udhëheqësit të Hezbollahut. Janë sulme të realizuara me dronë dhe raketa. Situata mbetet shqetësuese për Pentagonin. Këto baza amerikane, që u krijuan për të goditur bërthamat e fundit të ISIS janë të izoluar. Mund të furnizohen vetëm nga avionët. Dhe janë të rrethuara nga forca armiqësore...

Ato janë në shënjestër jo vetëm të formacioneve shiite, por edhe ushtrisë siriane, mercenarëve rusë, grupeve terroriste pranë Daesh apo Al Kaedës.

Në 30 tetor, forca ajrore amerikane bombardoi 2 polizione të grupeve filoiraniane, në zonën e gjelbër në kufirin Irak-Siri. Pikërisht aty ku kalojnë ndihmat luftarake nga Irani. Por as sulmi nuk i ndali inkursionet. Frika është se mos në ditët e ardhshme, Boshti i Rezistencës Shiite shtyn militantët të godasin ambasadat amerikane, apo të shtojnë fuqinë e sulmeve kundër strukturave ushtarake. Ka shqetësim edhe për Bahreinin, ku ndodhet Komanda e Flotës së Pestë dhe ku gysma e popullsisë është shiite.

Dje, dy aeroplanmbajtëset Eisenhower dhe Ford u afruan në brigjet e Qipros, për të shfaqur manovrat e avionëve të tyre dhe për t'i dërguar një mesazh aleatëve të Iranit.

Një task force e marinsave amerikanë në bordin e dy aniojeve helikopter-mbajtëse, të shoqëruara nga një kryqëzor me bateri antiraketë, u vendos në jug të Sinait.

Një lëvizje për të ndalur inkursionet e Houthëve të Jemenit, që deri sot kanë qenë më aktivët në lëshimin e raketave kundër Izraelit dhe mund të kërcënojnë të gjitha instalacionet amerikane në Lindjen e Mesme, nga aeroportet saudite deri tek ata të Emirateve.



## Muskuj dhe diplomaci

Në fjalimin e tij të shumëpritur nga Bejruti, i transmetuar drejtpërdrejt në televizion (por jo në Izrael), udhëheqësi i Hezbollahut, Hassan Nasrallah tregoi muskujt, por nuk e rrëmbeu pushkën. Të paktën tani për tani. Ai kërcënoi Izraelin, duke sfiduar Shtetet e Bashkuara. Por ishte i matur dhe evaziv.

Tha se "ne kemi qenë në luftë që nga 8 tetori", një ditë pas masakrës së tmerrshme të terroristëve të Hamasit në Izrael. Por nuk sqaroi sa shumë Hezbollahu synon të marrë pjesë në luftë. Dhe u përpoq të shfaqësonte Iranin, punëdhënësin e tij, duke thënë se ky ishte një veprim "100 për qind palestinez". Në një farë mënyre iu përgjigj drejtpërdrejt sekretarit amerikan të shtetit Antony Blinken, i cili duke folur pothuajse njëkohësisht në Tel Aviv tha se Shtetet e Bashkuara "do të bëjnë gjithçka për të shmangur hapjen e një fronti të dytë".

Edhe pse Benjamin Netanyahu i ishte përgjigjur negativisht propozimit të tij për një "pauzë humanitare" dhe ftesës "për të bërë më shumë për të mbrojtur civilët palestinezë". Udhëtimi i Blinken në Izrael, i dyti i tij që nga fillimi i krizës, kishte dy objektiva. Pikërisht për të shmangur një zgjerim të konfliktit. Dhe për të përforcuar linjën amerikane, të shpallur nga Joe Biden në vizitën e tij të rrufeshme në Tel Aviv: Izraeli ka çdo të drejtë të "ndërtojë fushatën e tij për të mposhtur Hamasin, por edhe mënyra se si e bën këtë ka rëndësi." Amerika, kishte thënë Biden, ka mësuar



nga gabimet e bëra pas 11 shtatorit: në Irak, në Afganistan. Një demokraci e vërtetë lufton dhe ndjek terroristët. Por duke e bërë këtë, duhet të mbrojtë civilët. Sepse edhe ata janë viktimë të egërsisë pa dallim të terrorizmit. Ky është mësimi i madh i demokracisë që Blinken i kujtoi dje Netanyahu, dhe që e përmbledhi në konferencën për shtyp me paralajmërimin se "ka rëndësi si e bën" (luftën kundër terrorizmit). Përndryshe ekziston rreziku i një reagimi dhe vala e antisemitizmit, që po rritet jo vetëm në vendet arabe është konfirmimi shqetësues i kësaj.

Për objektivin tjetër të Blinken, pra shmangien e hapjes së një fronti të dytë, duket se tani për tani ka një konsensus të heshtur, siç u pa edhe nga fjalimi i Nasrallah, i cili foli edhe për të ashtuquajturën "festë e dëshmorëve të rënë në rrugën për Jeruzalem", pra milicët e Hezbollahut që vdiqën në inkursionet në Izrael, që nisën nga Libani pas 7 tetorit.

Tani për tani, Hezbollahu i është përkushtuar shkatërrimit të sistemeve izraelite të vëzhgimit (radarë, kamera), lëshimin e raketave dhe kryerjen e sulmeve me komando. Ai e mban armën

drejtuar nga Izraeli, por e di se nëse hap një front të dytë tokësor, ai do të rrezikonte asgjësimin nga Tsahal. Netanyahu kërcënoi se do të "shkatërronte" Libanin, nëse Izraeli sulmohej nga territori i tij. Presidenti iranian Raisi shkroi në X (ish-Twitter) se Izraeli në Gaza "e ka kaluar vijën e kuqe dhe kjo mund t'i detyrojë të gjithë të ndërmarrin veprime". Por interesi i Iranit për momentin duket se është konsumimi i Izraelit, duke mbajtur presionin e lartë nga ana e përfaqësuesve të tij. Jo vetëm Hezbollah. Por edhe

milicët pro-iraniane në Siri dhe Irak, dhe mbi të gjitha Houthit në Jemen, të cilët javën e kaluar lëshuan raketa drejt Izraelit dhe që në të kaluarën kishin goditur disa objekte nafte në Arabinë Saudite, me raketa me precizion të lartë.

Prandaj, Irani, me pëlqimin e heshtur të Rusisë dhe Kinës, duket se synon një mbyetje të ngadaltë të Izraelit, duke e shtrënguar atë në një kontroll kërcënues, në vend që të hapë një front të dytë, i cili do të çonte në një përshkallëzim të pashmangshëm me pasojë të paimagjueshme për gjithë Lindjen e Mesme.

Por edhe mbajtja e siguresës të ndezur për një kohë të gjatë, siç duket se dëshiron të bëjë Teherani, sjell rreziqe të mëdha shpërthimi. Kjo është arsyeja pse Arabia Saudite, e cila e sheh në rrezik axhendën e saj ambicioze të modernizimit, të quajtur "Vizioni 2030", e cila përfshinte gjithashtu një normalizimin e marrëdhënieve me Izraelin, po lëviz në çdo drejtim për të parandaluar përshkallëzimin e luftës izraelito-paltestineze në gjithë Lindjen e Mesme.

Edhe Erdogan ka propozuar "mekanizmin e tij të sigurisë rajonale" për të parandaluar përhapjen e konfliktit. Por duke pasur parasysh paparashikueshmërinë dhe paqartësinë e personazhit, i cili propozohet si ndërmjetës në çdo krizë, është e vështirë të kuptohet nëse ai lëviz në interes të paqes apo më shumë me ambicion për të rikthyer Turqinë në lavditë e Perandorisë së vjetër Osmane. / Paolo Garimberti - La Repubblica (bota.al)

# Një ditë në jetën e Abed Salamait: Rrëfimi për dhembjen palestineze

Pjesë nga dy shkrime: A Day in the Life of Abed Salama – a story of Palestinian pain i gazetaris Boyd Tonkin [The Financial Times] dhe 'It's lonely being a Jewish critic of Israel' – Nathan Thrall on his book about a Palestinian father's tragedy i gazetares Rachel Cooke [The Observer]

Përmbledhi dhe përktheu: Telegrafi.com

Në faqen e parë të librit të Nathan Thrallit, nëpër rrugicat e mbushura me njerëz në një "matricë të kabllove, të telave dhe të dritave të llambave", Abed Salamai i prin djalit të tij pesëvjeçar, Miladit.

Kushdo që drejton makinën ose ecën nëpër Bregun Perëndimor, jashtë Jerusalemit, do të largohet me imazhet e ngatërresave, të grilave dhe labirinteve, të mëdhenj e të vegjël – që nga nyjat e improvizuara të linjave të shërbimeve në lagjet palestineze, e deri te rrjetat strategjike të gardheve, mureve, rrugëve dhe pikave të kontrollit që kanë prerë dhe copëtuar territorin që mbahej nga Jordania në luftën e vitit 1967 dhe që u pushtua nga Izraeli.

Në këtë tokë të gurtë, historia, politika dhe pushteti i rregullojnë faktet në terren.

\*\*\*

Thralli është gazetar dhe studiues hebraiko-amerikan nga Kalifornia, por që jeton në Jerusalem ku më parë ka drejtuar projektin arabo-izraelit të Grupit Ndërkombëtar të Krizave. Një ditë në jetën e Abdel Salamait [A Day in the Life of Abed Salama] burimin e ka te artikulli i gjatë i vitit 2021 për New York Review of Books. Libri ndjek aksidentin fatal në rrugën Xhaba, në veri të Jerusalemit në shkurt të vitit 2012, si dhe rezultatet e tij tragjike – si një mikrokozmos i jetës nën okupim në Bregun Perëndimor dhe si një dritare për atë që Thralli e quan "univers i fshehur i vuajtjeve që prek pothuajse çdo shtëpi palestineze".

\*\*\*

Autori shkruan me gjakftohtësi, me kujdes, pa retorikë apo shpifje. Nuk e pretendon neutralitetin. Poshtërimet e përditshme të pushtimit izraelit, nëpër çdo faqe tingëllojnë si të rrahurat e daulleve.

Dhjetëra të intervistuarit e tij shkojnë nga familja e gjerë e Abed Salamait (një labirint më vete) te hebrejtë e parë që reagon nga vendbanimet aty pranë, si dhe te koloneli Dany Tirza – te projektuesi kryesor i hartografisë së ndarjes të Bregut Perëndimor. Jaser Arafati atë e quajti Abu Kharita – "babai i hartës". Tirza

dyshon se Arafati ka dashur të thotë Abu Kharta – "babai i mutit". Ky oficer besonte se "paqja ishte në horizont", atëherë kur në mesin e viteve 1990 i shpiku këto lara në harta. Më vonë, pas bombardimeve të civilëve gjatë intifadës së dytë (që filloi në vitin 2000), ato nënkuptonin se "askund nuk mund të ndiheshë i sigurt", kështu që e planifikoi "pengesën ndarëse", më drastiken – prej mureve të betonit ose gardheve me shumë shtresa që tashmë gjarpërojnë rreth kodrave.

\*\*\*


Përmes një miku, Thralli ra në kontakt me Salamain. "Jetoj dy kilometra nga Anata. Për çdo javë kaloja nëpër atë vend". Fitimi i besimit ishte relativisht i drejtpërdrejtë; Salamai ishte i dëshpëruar t'i fliste dikujt për djalin e tij dhe tani i referohet Thrallit si "burri që e bëri të qajë" (e thotë këtë si lavdërim). Por, edhe izraelitët ishin të gatshëm të flisnin, meqë dyshimi zhdukej posa e takonin Thrallin: "E dija se e vetmja mënyrë për të pasur sukses është që njerëzit të mendojnë se është përshkrim i sinqertë; nëse të gjithë dukeshin njerëzorë, njerëz të vërtetë me motive, dashuri, xhelozë dhe ambicie".

\*\*\*

Në një mëngjes të lagësht dimri, të shkurtit 2012, një kamion me rimorkio në veri të Jerusalemit, në një autostradë të kontrolluar nga Izraeli ("Zona C"), e rrotulloi një autobus të vjetër që transportonte nxënësit palestinezë – nga shkolla private fillore "Nour al-Huda", për në qendrën lokale të lojërave. Zjari shpejt e përfshiu autobusin. U vranë gjashtë fëmijë dhe një mësues; shumë të tjerë u lënduan.

Në librin e tij, Thralli i përshkruan padrejtësitë e shumta që Salamai, si palestinez, duhej të duronte në orët dhe ditët pas aksidentit, duke filluar nga pamundësia për të udhëtuar për në spitalin ku Miladi mund të ishte i shtrirë. E ndjek kërkimin gjithnjë e më të furishëm të Abedit, për lajmet për Miladin. Kërkimi i tij me raste ndalet, për të na treguar historitë e të afërmeve të Abedit, komunitetin e tij në Anata dhe jetën – të hebrejtëve dhe të palestinezëve – të ndihmësve, mjekëve, ushtarëve, kolonëve dhe burokratëve që u përfshinë në atë tmerr.

Arkitektura e ndarjes së Bregut Perëndimor i pengoi komunikimet dhe i vonoi reagimet emergjente. Linjat ndarëse në tokë, si dhe linjat ndarëse në mendje, e shtonin



konfuzionin në enklavat e administruara nga palestinezët, në tokat e pushtuara dhe në Jerusalemin në përgjithësi. Edhe pse ishin aty pranë, ambulancat izraelite u zvarritën nëpër postbiloqe; Eldad Benshteini, mjeku që lindi në Moskë e që jetonte aty pranë, depërtoi në vendngjarje. Në vendin e përmbysjes, koloneli Saar Tzur ia lejoi zyrtarit palestinez Ibrahim Salama (kushëri i Abedit), që të marrë përsipër operacionin e shpëtimit. Saar Tzuri e kishte pezulluar edhe regjimin e kartave të identitetit që kufizonte lëvizjet e shumë palestinezëve rreth Jerusalemit. Por, prindërit ende kalonin nëpër mjegullën e mesazheve të përziera dhe të udhëzimeve të gabuara për spitalin ku mund të ishin fëmijët e tyre të plagosur ose të vdekur.

\*\*\*

Kronika e Thrallit jep paksa arsye për shpresë, për një bote më të mirë. Beber Vanunu, i lindur në Marok – kolon ky nga komuniteti Mizrahi i hebrejtëve historikisht të paprivilegjuar në Lindje të Mesme dhe në Afrikën e Veriut – i shtyri fqinjët që të bëjnë një flamur ngushëllimi që do të vendoset pranë pikës së kontrollit të rrugës Xhaba.

Por, para dhe gjatë kësaj narrative së shpresës dhe të frikës, Thralli ofron portretin grupor të klanit Salama, të miqve dhe të armiqtë të tyre. Politika e okupimit dhe protestat – veçanërisht zgjedhjet në lidhje me bashkëpunimin me autoritetet izraelite – ose vulosin lidhjet ose zgjerojnë çarjet mes klaneve. Gabimet e klanit e ndajnë Abedin nga dashuria e tij e parë, Ghazl – një vajzë e hamdanëve rivalë. Kjo përrallë e Romeos dhe Zhulietës dhe hija që kjo lëshoi mbi martesat e Abedit – së pari me Asmahanin e më pas me nënën e Miladit, Haifan –

ndonjëherë ka nuanca të novelës, sikur Ghazla e skuqur kalon pranë kërkuesit të saj që u refuzua, "e faqet e saj bëhen aq të kuqe, aq sa ai mund t'i shihte duke e ndryshuar ngjyrën edhe kur kalonte shpejt me makinë". Megjithatë, asnjë romantikë e tillë nuk e zbut gjuetinë e dëshpëruar për informacion, teksa Abedi dhe prindërit e tjerë kalojnë në labirintin e Bregut Perëndimor për të zbuluar fatin e fëmijëve të tyre. Disa gjejnë lehtësime; të tjerët – lajmin më të keq që mund të imagjinohet. Në vazhdën e përplasjes, fatkeqësia e re i përkeqëson mosmarrëveshjet familjare që ushqehen nga rëniet emocionale gjatë okupimit, ose nga tensionet e zjarra midis burrave me mendje tradicionale dhe grave që kërkojnë ndryshimin. Në një moment të tmerrshëm, një baba i zemëruar dëshiron të detyrojë bashkëshortin të shohë trupin e djegur të djalit të tyre: "Ajo e dërgoi në atë udhëtim – ajo duhet ta shohë rezultatit". Aksidenti, përfundon Thrall, "shkatërroi çdo familje, secilën në mënyrën e vet".

\*\*\*

Në çdo kohë, kjo vepër do t'i prekte lexuesit. Por, sot ballafaqohet me peizazhin e copëtuar kulturor ku simpatia dhe mirëkuptimi shkojnë vetëm në një rrugë të vetme. Duke folur së fundmi për gazetën hebraike të Nju-Jorkut, Forward, vetë Thralli shprehu frikën se mizoritë e pështira të Hamasit, më 7 tetor, mund të "egërsojnë pikërisht ata njerëz që shpresojnë t'i qasja përmes librit".

Në ditët pas sulmeve të Hamasit, ai e ka rënë në ankth mes brengave për gruan dhe për vajzat në shtëpinë e tyre në Jerusalem, si dhe të qenit i vetëdijshëm se teksa turneu për të promovuar librin e tij të ri po vazhdon, çdo paraqitje

publike është e mbushur me mundësitë për keqkuptime.

"Ngjarjet ma kanë bërë më të vështirë që të flas ... shumë njerëz që kanë lexuar librin, më thonë se e shohin si diçka të parashikueshme; e konsiderojnë si libër të domosdoshëm. Por, për disa të tjerë ka ndjenjën se po sjell një mesazh të nuancuar. Unë po u flas për jetën e hebrejtëve dhe të palestinezëve në një situatë që është qartësisht e padrejtë, ndërsa ata mendojnë se nuk mund të flasim për padrejtësi përballë mizorive".

Në libër ai përdor përvojat e të tjerëve për të ndriçuar atë që ai e quan "sistem" – strukturë represive të cilën e konsideron si të paqëndrueshme, por që nuk pret të ndryshojë së shpejti, çfarëdo që të ndodhë në Gazë: "Kjo është sfida më e madhe ... Kjo luftë nuk do të përfundojë me barazinë për hebrejtë dhe për palestinezët. Do të vazhdojë të ekzistojë një regjim i kontrollit të detyruar, pavarësisht nëse Izraeli është i pranishëm në Gazë, ose nëse arrin të gjejë përfaqësues në Autoritetin Palestinez që mund ta ndihmojë të kontrollojë Gazën, ose thjesht vendos ta lë Hamasin. Ndërkohë, duhet të rrafshojë Gazën për ta kënaqur publikun e vet; për t'ua dhënë atyre një përgjigje për pyetjen se si mund të besojnë se kjo më nuk do të ndodhë".

Të jesh hebre dhe kritik i Izraelit, kjo të bën të vetmuar. "Nëna ime ka lidhje fisnore me Izraelin. Nuk mund të durojë të lexojë asgjë që shkruaj ... Ndjej se kam përgjegjësi morale për të bërë atë që mundem. Atë përgjegjësi e ndjej si amerikan ... E ndjej si hebre, sepse qeveria izraelite pretendon se po vepron në emër të popullit hebraik; dhe e ndjej si genie njerëzore që jeton në Jerusalem dhe që ka miqësi të thella me palestinezët".

/Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova arrin fitore të rëndësishme ndaj Sllovakisë

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Ashtu si pritej, Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll ka reaguar pas humbjes së thellë të pësuar të enjten në Sllovaki. Të dielën në Prishtinë, djemtë tanë treguan se ndeshja në Sllovaki nuk ishte fytyra e vërtetë e "dardanëve". Të

dielën, Kosova fitoi 28:25 ndaj sllovakëve, që megjithatë avancojnë në kualifikimet për Botëror, falë fitores më të thellë në ndeshjen e parë. Kosova e nisi më mirë ndeshjen me Sllovakinë, ndërsa gjatë pjesës së parë ishte vazhdimisht para. Rezultati pas 30 minutave

megjithatë ishte 14:14. Edhe më e mirë ishte paraqitja në pjesën e dytë. Kishte lojë të mirë si në mbrojtje ashtu edhe në sulm dhe epërsia shkoi deri në pesë gola, 27:22. Në fund rezultati ishte 28:25. Portieri Haris Berisha kishte tjetër ndeshje të madhe, duke bërë 12 pritje. Nga gjashtë

gola i kishin kapiteni Valon Dedaj dhe Kushtrim Ninaj, që luajti ndeshjet e para zyrtare me Kosovën. Nga pesë gola i realizuan Egzon Gjuka e Leonard Gegaj, ndërsa tri i shënoi Luigj Quni. Por të gjithë lojtarët dhanë kontributin në fitoren e rëndësishme për kthimin e



vetëbesimit dhe të ardhmen e Kombëtares sonë.

## Prishtina ndahet baras me Llapin, Drita mposhtet nga Dukagjini

Derbi mes Prishtinës dhe Llapit nuk solli fitues, pasi skuadrat u ndan baras 2-2. Ndërsa edhe një hap pas në garën për titull e ka bërë Drita e Gjilanit që pësoi humbje në Klinë nga Dukagjini (1-0). Ndeshja mes Gjilanit dhe Ballkanit është zhvendosur në një afat të pacaktuar për shkak të angazhimit të klubit nga Suhareka në garat ndërkombëtare



**SUPERLIGA - Java e 13**

Prishtinë - Llapi	2-2
Dukagjini - Drita	1-0
Fushë Kosova - Liria	2-0
Feronikeli - Malisheva	0-0
Gjilani - Ballkani	(është shtyrë)

Tabela		Pikë
1. Ballkani	11	29
2. Drita	12	22
3. Llapi	13	22
4. Malisheva	13	17
5. Prishtina	13	17
6. Dukagjini	13	17
7. Gjilani	12	14
8. Feronikeli	13	12
9. Fushë Kosova	13	10
10. Liria	13	8

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 NËNTOR - Skuadra e Prishtinës dhe ajo e Llapit kanë ndarë pikët, pasi kanë luajtur të dielën në mbrëmje baras me rezultat 2-2, në derbin e javës së 13-të në Superligën e Kosovës që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri". Kryeqytetasit e mbyllën pjesën e parë me epërsi minimale 0-1, derisa golin e shënoi Jalen Blesa (28') nga penalltia. Në fillim të pjesës së dytë, Prishtina mbeti pa një lojtar pas përjashtimit të

Muhamed Useinit me karton të kuq. Në minutat në vazhdim Llapi e shtoi presionin edhe arriti të barazon rezultatin në minutën e 54-të, kur Muhamet Hyseni e shfrytëzoi një gabim të portierit Nika dhe realizoi për 1-1. Në minutën e 67-të, Hyseni edhe një herë doli në skenë duke realizuar për 1-2. Dhjetë minuta me vonë, vendasit e barazuan rezultatin me golin e Blesas. Pas kësaj ndeshje është në vendin e pestë me 17 pikë, kurse Llapi mbetet i treti në tabelë me 22 pikë. Ndërsa të dielën, Drita e ka regjistruar edhe një tjetër

rezultat negativ në elitë, pasi humbje si mysafire ndaj Dukagjinit në Klinë me rezultat 1-0. Në minutën e 58-të, Blerind Morina shënoi nga penalltia për rezultatin final 1-0. Drita barazoi në minutat shtesë rezultatin, por që pas rishikimit në VAR, gjyqtari Genc Nuza e anuloi golin për shkak se Blerim Krasniqi kishte prekur topin me dorë. Pas kësaj humbje, Drita mbetet në koutën e 22 pikë dhe

renditet në vendin e dytë, kurse Dukagjini vazhdon të mbetet i pamposhtur pas 11 xhirosh dhe aktualisht është në pozitën e pestë me 17 pikë. Në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan, Fushë Kosova e ka mposhtur Lirinë, me rezultat 2-0. Dominik Ivkiq (60) dhe Osman Mëziu (70) ishin shënues për Fushë Kosovën. Feronikeli 74 dhe Malisheva kanë

barazuar pa gola në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas. Edhe pse të dyja palët patën raste të shumta shënimi, nuk arritën të gjejnë golin. Madje, Feronikeli 74 pati mundësi të shënojë nga penalltia, por gjuajtjen e Jakup Berishës nga 11-metërshi e priti Flamur Gashi.

## Peja regjistron fitoren e shtatë radhazi, Ylli pas vazhdimeve fiton kundër Trepçës

Pejë, 5 nëntor - Peja ka shënuar fitoren e shtatë në shtatë përballje të zhvilluara në Prince Caffë Superligë. Verdhezinjtë kanë mundur Bashkimin me shifrat 91:83 (16:20, 23:12, 25:22, 27:29). Sfidën më mirë e nisën mysafirët, duke arritur epërsi në 9:20, por nga ky moment pejanët hyn në një seri të suksesshme, duke ngushtuar shifrat në 16:20, sa përfundoi çerekun i parë. Pejanët nuk u ndalën as në periudhën e dytë dhe bën përmbysjen ndaj prizrenasve, për të shkuar në pushim me rezultat 39:32. Edhe çerekun e tretë e kontrolluan vendasit që kishin

epërsi deri në 12 pikë, 64:52, ndërsa shifrat pas 30 minutash ishin 64:54. Përkundër tentimeve nga mysafirët, verdhezinjtë ruajtën epërsinë dhe triumfuan 91:83. Më i dalluari te Peja sërish ishte Justin Davis me 28 pikë, 11 kërcime e gjashtë asistime, ndërsa te Bashkimi u dalluan Erik Copes me 16 pikë e 11 kërcime, Isiah Umipig me 29 pikë dhe Grant Lozoya me 24 pikë, shtatë kërcime e pesë asistime. Peja ka shtatë fitore në shtatë ndeshje, njëherësh skuadra e vetme pa humbje, kurse Bashkimi numëron tri fitore e katër humbje. Në një sfidë me kthesa,



Golden Eagle Ylli ka mundur Trepçën në udhëtim me rezultat 68:71 (13:15, 11:19, 17:11, 20:16, 7:10). Përballja u zhvillua në kuadër të javës së shtatë të Prince Caffë

Superligës. Në çerekun e parë, vendasit e nisën me 4:0, por mysafirët u kthyen shpejt, ndërsa kjo pjesë u karakterizua me pak pikë, si pasojë e gabimeve, duke përfunduar 13:15. 'Xehetarët' nuk u këndellën as në periudhën e dytë, madje për dhjetë minuta shënuan 11 pikë, ndërsa Ylli shkoi në epërsi 24:24. Gjithsesi mitrovicasit ishin më të mirë në periodën e tretë, duke u rikthyer dalëngadalë, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 41:45. Vendasit vazhduan me lojë të mirë dhe arritën të kalojnë në epërsi 52:51, dhe dramë u zhvillua deri në fund

të çerekut të katërt kur Henrik Sirko barazoi rezultatin në 61:61, duke e dërguar sfidën në vazhdime, pasi aksioni i fundit nga vendasit ishte i pasuksesshëm. Edhe në vazhdime u zhvillua lojë interesante, ku vendimtar ishte Henrik Sirko dhe Ylli triumfoi 68:71. Te Trepça u dallua Jordy Tshimanga me nëntë pikë e 21 kërcime dhe Mikaille Tmusiq me 18 pikë e shtatë kërcime, ndërsa te Ylli më i miri ishte Henrik Sirko me 18 pikë e tetë kërcime. Tani mitrovicasit kanë pesë fitore e dy humbje, ndërsa therandasit tri fitore e katër humbje.

## Bajoku, boksieri më i mirë i turneut 'Adem Jashari'

Prishtinë, 5 nëntor - Kanë përfunduar edhe meçet finale të turneut të boksit "Adem Jashari". Për dy ditë me radhë ky turne, i 25-ti me radhë u

zhvillua në sallën "1 Tetori" në Prishtinë. Pjesëmarrës ishin boksierë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Zvicra dhe Sllovakia. Boksieri

më i mirë u shpall Shpëtim Bajoku, ndërsa çifti më luftarak ishte dyshja Taulant Jakupi dhe Ukë Smajli. Boksieri më perspektiv u shpall Useid Nika

nga Shqipëria. Boksieri më i mirë i huaj Alim Nasufi nga Maqedonia e Veriut, kurse tekniku më i mirë u shpall Erik Katona nga Sllovakia.



